

VENDIM
Nr.10, datë 2.2.2007

**PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE PËR GRANTIN “PËR
KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- z.Genc Ruli	Kryetar
- znj.Mimoza Dhëmbi	Anëtare
- znj.Mimoza Vokshi	Anëtare
- z.Viktor Gumi	Anëtar
- z.Ledi Bianku	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 2.2.2007, shqyrtoi raportin “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për dhënien e grantit “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë””. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore nga Drejtoria e Nxitjes së Biznesit në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me shkresën nr.511, datë 19.1.2007 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.3, datë 19.1.2007.

Baza ligjore: Si bazë për dhënien e grantit “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë” është ligji nr.9645, datë 27.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, si dhe projektvendimi “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë”.

Objektivat: Objektivi kryesor i skemës është rritja e aftësisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për të përballuar presionin konkurrues të tregut rajonal dhe europian, nëpërmjet rritjes së cilësisë së prodhimit e menaxhimit, integritit të tyre dhe nxjerrjes së produkteve që të përmbushin kërkesat e standardeve të këtij tregu.

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndihmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Plani për dhënien e grantit “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë”, synon mbështetjen e veprimtarive që lidhen vetëm me:

- përmirësime teknologjike për përshtatje produkti, përfshirë ambalazhimin dhe etiketimin, certifikim produkti, vlerësim konformiteti dhe zbatim të sistemeve të cilësisë;
- shërbime këshillimore në formën e studimeve të tregut të trajnimeve;
- pjesëmarrjen për herë të parë jashtë shtetit, në një panair ose ekspozitë, si vizitor apo ekspozues.

2. Maksimumi i vlerës së grantit për një ndërmarrje të vetme është 1 000 000 lekë, gjë që nuk sjell ndikim të ndjeshëm në konkurrencë.

3. Skema ofron subvencionim për kosto që kanë të bëjnë me aktivitete rigorozisht të përcaktuara dhe, në asnjë rast, më shumë se 50% e kostove të pranueshme, pra funksionon mbi bazën e parimit të ndarjes së kostove.

4. Skema përcakton se përzgjedhja e ndërmarrjeve bëhet mbi bazë të respektimit të kushteve, të dhëna në mënyrë të përgjithshme dhe të pacaktuar.

5. Skema nuk ka karakter përzgjedhës për sektorë të veçantë, por përjashton një pjesë të ndërmarrjeve publike ose me kapital shtetëror, që nuk janë në proces privatizimi.

6. ALBINVEST do të jetë institucioni menaxhues i skemës, duke mos qenë vetë një përfitues i drejtpërdrejtë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, mbështetur në nenin 8 dhe nenin 22 pika 2 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”,

VENDOSI:

1. Të hiqet kushti i shprehur në shkronjën “a” të pikës 3 të projektvendimit “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë”.
2. Me zbatimin e pikës 1 të këtij vendimi, të miratojë planin për dhënien e grantit “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë”.
3. ALBINVEST të raportojë deri më 31 mars të çdo viti pranë DNSH, për ndihmën e dhënë nga zbatimi i kësaj skeme gjatë vitit paraardhës financiar.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Genc Ruli